

Të dashur prindër:

Shkollat e Komunitetit Utica janë duke bërë planet për pjesën e mbetur të vitit shkollor 2020-2021. Këto plane përfshijnë përgatitjen e orareve për semestrin e dytë, i cili fillon me 4 Janar.

Ndërsa po krijojmë orare dhe caktojmë stafin, ne duhet të dimë se sa nxënës do të regjistrohen në udhëzimet në person/në distancë ose në Akademinë Virtuale të UCS për semestrin e dytë.

Opsioni i të mësuarit **në person/mësim në distancë** do të mundësojë që nxënësit të kalojnë në të mësuarit në person kur faktorët e shëndetit dhe sigurisë na lejojnë të kthehemi në klasat tona. Prindërit që bëjnë këtë zgjedhje po vendosin që nxënësit/fëmijët e tyre të ndjekin shkollën në njërën nga situatat e mëposhtme:

- Plotësisht në person në çdo kohë
- Modeli hybrid (gjysëm dite)
- Plotësisht në distancë

**Akademia Virtuale UCS** është opsioni plotësisht on-line i distriktit. Nxënësi/fëmija juaj do të qëndrojë në një mjedis virtual të të mësuarit gjatë pjesës së mbetur të këtij viti shkollor.

Pavarësisht nga opsioni që ju zgjidhni, nxënësi/fëmija juaj do të mësohet nga mësues të kualifikuar të Shkollave të Komunitetit Utica me planprogram që do të jetë paralel në të gjitha metodat dhe mjediset e ndryshme të të mësuarit.

Ju lutemi, merrni pak kohë për të diskutuar se cili opsion funksionon më mirë për familjen tuaj. Gjthashtu, ne jemi këtu për t'ju ndihmuar nëse keni ndonjë pyetje. Përsëri, zgjidhja juaj do të mbetet në fuqi deri në fund të vitit shkollor.

Ndërsa ne po angazhohemi në procesin e planifikimit, ne po kërkojmë që të na informoni për zgjedhjen tuaj deri në orën 11:59 pasdite, me 15 Nëntor. Mund të bëni zgjedhjen tuaj duke klikuar në këtë [link](#). Një Faqe e Pyetjeve të bëra më shpesh në lidhje me këto zgjedhje është gjithashtu në dispozicion në këtë [link](#). Përsëri, zgjedhja juaj do të mbetet në fuqi deri në fund të vitit shkollor. Nëse nuk bëni një përzgjedhje, ne do t'ju mbajmë në planin tuaj aktual të të mësuarit.